



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:225325
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06151553

C.nr. 2497/24.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm - Departamenti Civil, me gjyqtarin Migjen Kastrati, në çështjen juridike kontestimore të palës paditëse, B.O, nga fshati P, Komuna e Istogut, të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Blerim Ademaj, avokat në Pejë, kundër të paditurit S (S) V, nga Peja, Rr. Zh. S, nr. 97, Pejë, me objekt kontesti, vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit, 1,000.00 Euro, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurën e ndërmjetësimit, gjykata jashtë seancës me datën 12.09.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE me numër Nd.nr. 1300/24 e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Pejë me datën 05.09.2024 e lidhur në mes të palës paditëse, B.O, nga fshati P, Komuna e Istogut, të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Blerim Ademaj, avokat në Pejë, kundër të paditurit S (S) V, nga Peja, Rr. Zh. S, nr. 97, Pejë, me objekt kontesti, vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit 1,000.00 Euro.

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr. 1300/24 e datës 05.09.2024 e cila e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurit, me objekt kontesti, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit 1,000.00 Euro.

Në Qendrën e Ndërmjetësimit kjo lëndë është referuar me datën 05.09.2024 dhe palët ndërgjyqëse me datën 05.09.2024 respektivisht i autorizuari i palës paditëse me të paditurin,

kanë arritur marrëveshjen për këtë çështje juridiko civile dhe gjykatës i është dorëzuar marrëveshja e arritur në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes se ndërmjetësimit me nr. të referencës Nd.nr. 1300/24 të datës 05.09.2024 e lidhur në Qendrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Pejë, në mes të autorizuarit të palës paditëse dhe të paditurit, me objekt kontesti, vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit 1,000.00 Euro (për më tepër sikurse në marrëveshjen e datës 05.09.2024 pjesë e shkresave të lëndës), vlerëson se kjo marrëveshje i plotëson kushtet ligjore, pasi që kjo gjykatë ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 3.3 dhe nenit, 411, 412 e lidhur me nenin 142 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 2,3, 4,5,6,7,8, 10, 11, 12, 14, 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr. 06/L-009, erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të miratohet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

Nga të lartcekurat, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:225325, C.nr. 2497/24 i dt. 12.09.2024**

**G j y q t a r i
Migjen Kastrati**

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.